




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Nr.21/24
Prishtinë, më 26.02.2024

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6 neni 39 si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.4, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në propozimin e datës 06.10.2023 me Nr. Prot. 472/23-01H nga ndërmarrja “Euroлона” Shpk me adresë: Miradi e Epërme, Fushë Kosovë, kundër Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) me adresë: Rr. Ukshin Hoti - Kompleksi ‘Ramiz Sadiku’ 10000 Prishtinë Kosovë, me pretendimin se nuk ka lejuar konkurrencën e lirë në licencimi për importin e mëshqerrave barrëse për riprodhim, në mbledhjen e mbajtur me datën 26.02.2024 merr këtë:

KONKLUZION

Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, konstatohet se nuk ka kushte për fillimin e Procedurës Hetimore ndaj Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), sipas nenit 36 paragrafi 6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës me datë 06.10.2023 me Nr. Prot. 472/23-01H ka pranuar propozimin nga ndërmarrja “Euroлона” Shpk, kundër Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë, me pretendimin se nuk ka lejuar konkurrencën e lirë në licencën për importin e mëshqerrave barrëse për riprodhim.

Pretendimet e paraqitësit të iniciativës:

Sipas pretendimeve, importi i mëshqerrave barrëse për riprodhim është një aktivitet specifik, i cili nuk mund të bëhet nga çdo kush, pasi që duhet plotësuar kritere dhe për këtë arsye kërkohet licencim në bazë të kritereve nga Udhëzimet Administrative Nr. 16/2013, Nr.15/2014, si dhe plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ, Nr.05/2015.

Në bazë të kritereve të Udhëzimit Administrativ (edhe pse asnjë herë institucioni nuk e ka implementuar në bazë të kritereve këtë udhëzim) ne kemi qenë të licencuar ndër kompanitë e para pas lufte, kemi bashkëpunuar me shumë institucione vendore, ndërkombëtare, OJQ të ndryshme dhe asnjë herë as vërejtjen më të vogël nuk e kemi pasur nga organet monitoruese për aktivitetin e tillë, përkundrazi kemi pasur vetëm lëvdata. Duke marrë parasysh rrethanat dhe kushtet që ne posedojmë, në krahasim me kompanitë e tjera që janë lejuar dhe lejohen edhe

tash të ushtrojnë këtë aktivitet, pa plotësuar as edhe një kriter të vetëm në bazë të UD i cili do të duhej të vlejë njëjtë për të gjithë dhe për të cilin UD ne jemi eliminuar si kompani, ndërsa kompanitë tjera nuk kanë kushte as minimale apo ekstrem të tmerrshme në krahasim me ne dhe ata lejohen pa pengesë të punojnë. Këtu kemi të bëjmë me një shkelje flagrante, klasike, tendencioze të konkurrencës dhe shkelje të UD në të cilin thirren dhe kemi favorizim të hapur të kompanive të tjera apo të caktuara;

Në bazë kësaj ne jemi të bindur se ekzistojnë fakte të mjaftueshme për inicim të kësaj procedure nga Autoriteti i Konkurrencës;

Ndër të tjera, në shkresën e lëndës ndërmarrja ka potencuar se:

“Ne posedojmë edhe prova, foto, video, ku janë duke u vendosur mëshqerrat barrës, të cilat do t’u shiten fermerëve ku kemi të bëjmë me shkelje të ligjit, mashtrim të institucioneve të caktuara, shmangie e tatimit etj.

Sipas deklarimeve, ndërmarrja ka pas shtrirje në tërë territorin e Kosovës, ne vazhdimësi e po ashtu edhe kërkesa nga disa vende të regjionit; Pjesëmarrja jonë në tregun e Kosovës është rreth 35-40%, edhe pse nuk ka statistika të sakta.

Ndërmarrjet të cilat kanë pasur leje të tilla furnizuese, e që edhe me tutje afarojnë në treg pa asnjë problem të cilat janë; Agro Gold-Dragash, Appetit-Prishtinë, Agoni-Pejë, Ferma Kosova-Deçan, mund të ketë edhe të tjera të licencuara, por jo-aktive;

Efektet negative ndaj biznesit tonë janë të pariparueshme, të paimagjinueshme, përpos dëmit material dhe pamundësisë së furnizimit të fermerëve dhe realizimit të kontratave me bashkëpunëtorët tanë vendorë dhe të jashtëm, dëmi dhe më e keqja e krejt kësaj është, se ky veprim, apo penalizimi i kompanisë sonë ka ndikuar tepër keq sidomos në imazhin e kompanisë. Me shumë mundësi sakrificë, si në Kosovë ashtu edhe me partnerët tanë nga shtetet e BE-së, sepse nga të gjithë fermerët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm përfillet se ne kemi bërë shkelje dhe mashtrim dhe për këtë arsye na është ndaluar ky aktivitet dhe mendoj se ky dezinformim është iniciuar edhe nga konkurrentët tanë.

Dëmi financiar është rreth 150-200 mijë €, por dëmi më i madh dhe i pariparueshëm për ne është dëmtimi i imazhit të kompanisë sonë i krijuar ndër vite;

Ne kemi ndërmarrë masat tona dhe kemi kërkuar rishqyrtim të lëndës sonë, pasi që në bazë të kriterëve të përcaktuara nga UA, kompanitë tjera po vazhdojnë aktivitetin, pa ndryshuar dhe plotësuar asnjë kriter të përcaktuar, por përgjigjja ka qenë negative ose nuk kemi marrë përgjigje.

Një ndër kriteret që ne kinse nuk i plotësojmë është arsyetimi se, objektet për karantinë të mëshqerrave duhet që së paku të jenë 500m larg nga vendbanimi (Kriter që deri më tani e paskemi plotësuar, pa bërë asnjë ndryshim në kriteret e kërkuara rreth viteve të 80-ta dhe shtëpitë janë ndërtuar dhe afruar objekteve mbasi që është ndërtuar kompleksi i fermave e sidomos pas lufte.

Nevojat për mëshqerra barrëse, nga BE-ja në bazë të analizave dhe kërkesave janë ende të mëdha, sidomos për këtë vit dhe vitin e ardhshëm pasi që përfolët se do të subvencionojë Ministria, një numër të madh të mëshqerrave për fermerë dhe kjo është një ndër arsyet se ne na kanë eliminuar nga konkurrenca për t’iu hapur rrugë kompanive të preferuara.

Takimi me përfaqësuesit e MBPZHR

Me qëllim të krijimit të një pasqyreje të gjendjes, është zhvilluar një takim me përfaqësuesit e MBPZHR. Në këtë takim janë diskutuar pretendimet e ndërmarrjes “Euroлона” SH.P.K. Përfaqësuesit e MBPZHR-së, kanë paraqitur arsyetimet e tyre për kriteret që kërkohen me UA dhe për mos-plotësimin e tyre nga ndërmarrja në fjalë.

Përshkrimi i Gjendjes Faktike të rastit

Komisioni për shqyrtimin e kushteve tekniko - teknologjike të objekteve dhe pajisjeve për ruajtjen, mbajtjen dhe transportin e materialit biologjik riprodhues (në vazhdim: Komisioni), Vendimi, Datë: 19.09.2022, Ref. ZSP 506/22 Nr. 326 në zbatim të legjislacionit, Udhëzimit Administrativ Nr.16/2013 për “Riprodhimin e kafshëve të Fermës” neni 4 pika 2 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2014 dhe plotësim ndryshimin e këtij udhëzimi Nr. 05/2015 për Vendosjen e kafshëve të gjalla në karantinë, ka marrë mandatin zyrtar, ditën e nënshkrimit të Vendimit, me datë 27.04.2022, sipas vendimit të lartpërmendur.

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.16/2013 për “Riprodhimin e kafshëve të Fermës” neni 4 pika 2 operatorët njoftohen për afatin e skadimit të licencës dhe te njëjtët kanë të drejtë aplikimi për vazhdim të licencës. Aplikimi për licencim, i operatorit “Euroлона” SHPK sipas procedurave, me datë: 16.03.2023 ka paraqitur kërkesë për vazhdim të licencës, Kërkesa Nr. arkivues 1019. Komisioni, në përbërje të plotë, pas shqyrtimit të dokumentacionit ka konstatuar se Kërkesa e operatorit Euroлона” SHPK ka të kompletuar dokumentacionin, sipas kërkesave ligjore, me datë 20.03.2023 ka realizuar vizitën në fermë për të shqyrtuar kushtet tekniko - teknologjike të objekteve dhe pajisjeve për ruajtjen, mbajtjen dhe transportin e materialit biologjik riprodhues duke vizituar fermën e parashtruesit të kërkesës për licencim.

Gjatë shqyrtimit të lëndës dhe vizitës në fermë, për shqyrtimin e kushteve tekniko - teknologjike të objekteve dhe pajisjeve për ruajtjen, mbajtjen dhe transportin e materialit biologjik riprodhues, Komisioni sipas kriterëve të Nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2014 dhe plotësim ndryshimin e këtij udhëzimi Nr. 05/2015 për Vendosjen e kafshëve të gjalla në karantinë ka konstatuar se nuk janë ndërmarrë masat për arritjen e kriterëve ligjore për licencim dhe për të njëjtën ka marrë vendim për mos vazhdim të licencës për operatorin “Euroлона” SH.P.K. Lidhur me vendimin e Komisionit, operatori “Euroлона” SH.P.K, zyrtarisht është njoftuar me Raportin e Komisionit, datë 28.04.2023, Nr. arkivues: 1776.

Bazuar në legjislacionin: Udhëzimin Administrativ Nr.16/2013 për “Riprodhimin e kafshëve të Fermës” dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 15/2014 dhe plotësim ndryshimin e këtij udhëzimi Nr. 05/2015 për “Vendosjen e kafshëve të gjalla në karantinë” dhe të gjeturave të Komisionit nga shqyrtimi i kushteve tekniko - teknologjike të objekteve dhe pajisjeve për ruajtjen, mbajtjen dhe transportin e materialit biologjik riprodhues për vendosjen e kafshëve në karantinë në fermat e operatorëve të cilët janë administruar deri më tani nga Komisioni janë hasur parregullsi dhe mos plotësim të kushteve për sa vijojnë:

1. Objektet e karantinës së kafshëve janë në distancë me të shkurtër se 500 m, nga vendbanimi dhe objektet e vendbanimit, vendi i objekteve në të cilat janë të vendosura kafshët vendore, kafileritë varrezat e kafshëve, pika 1.2 e Nenit 3;

2. Objekti i karantinës / stallës ka hapësirë për të siguruar lidhshmëri funksionale por nuk është i rrethuar me rrethoja në lartësi së paku 1.80 m;
3. Objektet kanë më shumë se një hyrje për lëvizje të njerëzve dhe kafshëve dhe sigurimin e bartjes së ushqimit dhe materialit tjetër të nevojshëm, pika 1.4 e Nenit 3;
4. Objektet nuk kanë të instaluar ujëpirëset për furnizim të vazhdueshëm me ujë të pijshëm dhe për nevojat tjera të fermës, pika 1.5 e Nenit;
5. Objektet nuk kanë barriera të përhershme dezinfektuese për personel dhe automjete, pika 1.7 e Nenit 3 dhe;
6. Objektet kryesisht nuk kanë hapësirë të përhershme për larjen dhe dezinfektimin e automjeteve pas shkarkimit të kafshëve, pika 1.8 e Nenit 3

Kushtet, sipas 1 (një) janë problem për të gjithë operatorët, marrë parasysh se në zonat në të cilat janë fermat, të cilat kanë aplikuar për licencim dhe vazhdim të licencës për Vendosjen e kafshëve të gjalla në karantinë, janë të ndërtuara para objekteve të banimit. Sa i përket Objekteve të banimit në afërsi të fermave për vendosjen e kafshëve të gjalla në karantinë, nuk është në mandatin e Komisionit që të verifikojë të dhënat nëse janë të pajisura me leje ndërtimi. Lidhur me këtë problem Komisioni është duke përgatitur raport profesional.

Kushtet, sipas pikave 2 (dy) deri në 6 (gjashtë), janë në përgjegjësi të pronarit, personit përgjegjës të autorizuar për përkujdesje të kafshëve dhe veterinerit të kontraktuar, Ligji Nr. 02/L-10 për Përkujdesjen ndaj kafshëve, pika 5.1 e nenit 5. Në aspekt teknik dhe praktikave zooteknike, ka mundësi që të arrihen me investimet që duhet bërë ose duhet të mirëmbahen në vazhdimësi. Këto kushte, sipas legjislacionit për veterinari, para vendosjes së kafshëve në karantinë, verifikohen nga inspektorët e veterinarisë dhe për të njëjtën përgatitet procesverbal me rekomandime. Rekomandimet sipas pikave 2 (dy) deri në 6 (gjashtë), janë të ndërlidhura me shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve prandaj edhe janë të pa diskutueshme nga Komisioni.

Parashtruesi i kërkesës për licencim pas shqyrtimit të Kërkesës me dokumentacionin e bashkëngjitur dhe shqyrtimi i kushteve tekniko - teknologjike të objekteve dhe pajisjeve për ruajtjen, mbajtjen dhe transportin e materialit biologjik riprodhues për vendosjen e kafshëve në karantinë sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2014 dhe plotësim ndryshimin e këtij udhëzimi Nr. 05/2015 për "Vendosjen e kafshëve të gjalla në karantinë" pas njoftimit zyrtar, deri në plotësim të kriterëve sipas nenit 3 të udhëzimit administrativ si më lartë, nuk licencohet / nuk i vazhdohet licenca dhe nuk mund të merret me import të materialit biologjik për riprodhim/mëshqerra për riprodhim.

Analiza e Konkurrencës

1. Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, abuzimin me pozitën dominuese, si dhe përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg.
2. Mandati themelor i AKRK-së është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe kjo nënkupton që AKRK vepron kur cenohet, pengohet ose shtrembërohet konkurrenca në treg. Më konkretisht, Autoriteti i Konkurrencës reagon në ato raste kur ndërmarrjet veprojnë në

mënyrë të koordinuar (pra, nëse një veprim i tillë është rezultat i marrëveshjes së tyre eksplicite, përmes formës së kartelit-marrëveshjes së ndaluar apo sjelljeve të tyre në treg - praktikës së bashkërenduar). Gjithashtu, AKRK mund të reagojë edhe ndaj ndërmarrjeve që kanë pozitë dominuese në treg dhe të cilat keqpërdorin këtë pozitë.

3. Autoriteti i Konkurrencës zhvillimin e procedurës e bazon në nenin 35 – Propozimi për Fillimin e Procedurës dhe ex-officio neni 36 - Fillimi i Procedurës, dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që operojnë në tregjet përkatëse. Neni 3 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, e definon përkufizimin Ndërmarrje sipas të drejtës së konkurrencës, si vijon:

“Ndërmarrje - çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, i angazhuar në veprimtari ekonomike, pavarësisht statusit juridik dhe mënyrës së financimit. Organi publik quhet ndërmarrje nëse angazhohet në veprimtari ekonomike.

4. Autoriteti kryen detyrat si një organ i pavarur për mbrojtjen e konkurrencës, në të gjitha tregjet ekskluzivisht brenda fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara nga Ligji Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
5. Autoriteti në rastin konkret, nuk është kompetent për zbatimin e ligjeve të veçanta, por aspekti ligjor dhe rregullativ është në kompetencë të institucioneve tjera, e në këtë rast të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Andaj edhe procedura e licencimit dhe veprimet e tjera, që lidhen me vlerësimin profesional janë kompetencë e këtij institucioni.
6. Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Komisioni

Neime Binaku - Isufi

Kryetare




Kaltrina Sela
Nënkryetare



Florent Mehmeti
Anëtar



Nafije Osdautaj
Anëtare



Salihe Gashi Loku
Anëtare



Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Pala ankuese (Ministria e Drejtesise)
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva